



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 11 korrik 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendimi i Dytë mbi Heqjen e Redaktimeve ose Zbatimin e Redaktimeve të Reja
në Transkriptet e Seancave Gjyqësore dhe Riklasifikimin e Tyre**

Me Shtojcën 1 Konfidenciale

T'u njoftohet:

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtjes së të akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Zyrës Administrative
Fidelma Donlon

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykses) lëshon këtë vendim të dytë për heqjen e redaktimeve ose zbatimin e redaktimeve të reja në transkriptet e seancave gjyqësore dhe riklasifikimin e tyre.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Nga 1 deri më 3 maj 2023, Trupi Gjykses dëgjoi dëshmitë e dëshmitarëve TW4-10 dhe TW4-11 (blloku i dytë i dëshmive), të cilët përfitojnë nga masa mbrojtëse kundrejt publikut.¹

2. Më 15 maj 2023, Trupi Gjykses urdhëroi palët dhe Mbrojtësin e Viktimave të bënë një rishikim të transkripteve të seancave gjyqësore të lartpërmendura dhe të paraqisnin parashtrime, në një parashtrim përmbledhës, nëse mund të hiqen redaktimet ekzistuese dhe/ose transkriptet të riklasifikohen si publike.²

3. Më 30 maj 2023, palët dhe Mbrojtësi i Viktimave dorëzuan një propozim të përbashkët për heqjen e redaktimeve dhe/ose riklasifikimin e transkripteve të seancave gjyqësore të lartpërmendura ("Propozimi i Përbashkët").³

4. Më 9 qershor 2023, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) e Zyrës Administrative dorëzoi propozimet e veta përmes postës elektronike ("Propozimet e ZMMD-së").⁴

¹ KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 1 maj 2023, publik, f. 1021-1135; Transkripti i seancës, 2 maj 2023, publik, f. 1136-1236; Transkripti i seancës, 3 maj 2023, publik, f. 1237-1348

² KSC-BC-2020-04, F00510, Trupi Gjykses I, Urdhri i Dytë për Parashtrime në lidhje me Heqjen e Redaktimeve dhe/ose Riklasifikimin e Transkripteve të Seancave Gjyqësore, 15 maj 2023, publik

³ KSC-BC-2020-04, F00526, Prokurori i Specializuar, Parashtrimi i Prokurorisë i Propozimit të Përbashkët sipas Urdhrit F00510, 30 maj 2023, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁴ KSC-BC-2020-04, CRSPD86, Mesazh Elektronik nga Trupi Gjykses I drejtuar NJAGJ-së në lidhje me Redaktimet e Propozuara të ZMMD-së në Transkriptin e 1-3 majit 2023, 12 qershor 2023, konfidencial.

II. PARASHTRIME

5. Palët dhe Mbrojtësi i Viktimave propozojnë riklasifikimin si publike të pjesëve të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura midis 1 dhe 3 majit 2023 në seancë private në varësi të zbatimit të redaktimeve, kur është e nevojshme për mbrojtjen e identiteteve dhe informacioneve konfidenciale të dëshmitarëve.⁵ Gjithashtu, palët dhe Mbrojtësi i Viktimave parashtrojnë se një numër redaktimesh të autorizuara më parë nga Trupi Gjykses në seancat gjyqësore të 2 dhe 3 majit 2023, mund të hiqen.⁶ Së fundi, palët dhe Mbrojtësi i Viktimave propozojnë redaktime të vogla në transkriptin e seancës gjyqësore të 3 majit 2023, mbajtur në seancë të hapur.⁷

6. ZMMD-ja propozon zbatimin e redaktimeve shtesë në pjesë të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura në seancë private më 2 dhe 3 maj 2023, që palët dhe Mbrojtësi i Viktimave kërkojnë të riklasifikohen si publike.⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Trupi Gjykses mbështetet në nenet 21(2), 23, 40(2), (4) dhe (6)(f) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 80, 84(1) dhe 120 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

IV. ANALIZË

8. Trupi Gjykses rikujton se, në bazë të nenit 21(2) të Ligjit dhe në varësi të masave mbrojtëse të urdhëruara sipas nenit 23 të Ligjit për mbrojtjen e

⁵ Shtojca 1 e Propozimit të Përbashkët, f. 2-9.

⁶ Shtojca 1 e Propozimit të Përbashkët, f. 5, 7.

⁷ Shtojca 1 e Propozimit të Përbashkët, f. 7, 9.

⁸ *Shih* Propozimet e ZMMD-së.

dëshmitarëve dhe viktimave, i akuzuari ka të drejtën që gjykimi në të cilin do të vendoset për akuzat kundër tij të jetë publik. Me qëllim respektimin e parimit të publicitetit dhe ruajtjes në të njëjtën kohë të masave mbrojtëse ekzistuese, Trupi Gjykses ushtroi detyrën e tij sipas rregullës 84(1) të Rregullores për rishikimin e klasifikimit të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura midis 1 dhe 3 majit 2023 dhe urdhëron përmes këtij vendimi riklasifikimin e tyre, sipas rastit, siç përcaktohet më poshtë.

9. Trupi Gjykses do të shqyrtojë fillimisht propozimet e palëve dhe të Mbrojtësit të Viktimave sa u përket transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura në seancë të hapur, konkretisht heqjen e redaktimeve të autorizuara më herët nga Trupi Gjykses (redaktimet ekzistuese) dhe zbatimin e redaktimeve të reja në transkriptin e seancës gjyqësore të 3 majit 2023. Së dyti, Trupi Gjykses do të trajtojë propozimet në lidhje me riklasifikimin si publike të pjesëve të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura në seancë private dhe zbatimin më pas të redaktimeve në to. Për lehtësi referimi, Trupi Gjykses do t'i rendisë propozimet e miratuara në një shtojcë bashkëlidhur këtij vendimi.

A. TRANSKRIPTET E SEANCAVE GJYQËSORE TË MBAJTURA NË SEANCË TË HAPUR

1. Heqja e redaktimeve ekzistuese

10. Trupi Gjykses vë në dukje se palët dhe Mbrojtësi i Viktimave kërkojnë të bëjnë publike disa informacione që kanë të bëjnë me dëshminë e TW4-11-ës, të cilat janë redaktuar më parë nga Trupi Gjykses gjatë seancave gjyqësore të mbajtura në seancë publike më 2 dhe 3 maj 2023.⁹

11. Sa i përket propozimit të palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave për heqjen e një redaktimi ekzistues nga transkripti i seancës gjyqësore të 2 majit 2023, Trupi Gjykses e konsideron këtë në përputhje me qasjen e Trupit Gjykses ndaj mbrojtjes

⁹ Shtojca 1 e Propozimit të Përbashkët, f. 5, 7.

së dëshmitarëve dhe viktimave sipas nenit 23 të Ligjit. Në veçanti, Trupi Gjykses është i mendimit se ky propozim vendos drejtpeshimin e duhur midis të drejtave dhe interesave të ndryshme, konkretisht, parimit të publicitetit sipas nenit 40(4) të Ligjit dhe të drejtave të të akuzuarit për seancë publike sipas nenit 21(2) të Ligjit dhe mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimave sipas nenit 23 të Ligjit. Rrjedhimisht, trupi Gjykses miraton kërkesën e palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave që informacionet në fjalë të bëhen publike.

12. Megjithatë, Trupi Gjykses hedh poshtë kërkesat e tyre që pjesë të transkriptit të seancës gjyqësore të 3 majit 2023, të redaktuara më herët nga Trupi Gjykses, të bëhen publike, pasi ato përmbajnë informacione që mund të çojnë në identifikimin e dëshmitarëve.

13. Më tej, Trupi Gjykses gjykon se për zbatimin e plotë të parimit të publicitetit, përveç propozimeve të palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave, mund të hiqet edhe një redaktim tjetër ekzistues, i autorizuar gjatë seancës gjyqësore të 1 majit 2023.

14. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses: (i) autorizon heqjen e redaktimeve ekzistuese në përputhje me shtojcën e këtij vendimi; dhe (ii) udhëzon Zyrën Administrative të heqë redaktimet ekzistuese në versionet e redaktuara publike të transkripteve përkatëse, në përputhje me udhëzimet në shtojcën e këtij vendimi. Udhëzimet e Trupit Gjykses duhet të zbatohen njësoj për transkriptet në gjuhët shqipe dhe serbishte.

2. Redaktimet pas seancës

15. Trupi Gjykses vë në dukje se palët dhe Mbrojtësi i Viktimave kërkojnë në dy raste zbatimin e redaktimeve të reja në transkriptin e seancës gjyqësore të 3 majit 2023.¹⁰ Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton se pjesët e transkripteve të seancave të hapura, përfshirë materialet gjegjëse audio-video, janë tashmë të

¹⁰ Shtojca 1 e Propozimit të Përbashkët, f. 7, 9.

disponueshme për publikun dhe zbatimi i redaktimeve të reja përbën redaktim pas seancës.

16. Trupi Gjykses konstaton se propozimet e palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave sa u përket redaktimeve pas seancave janë në përputhje me qasjen e Trupit Gjykses ndaj mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimave sipas nenit 23 të Ligjit dhe vendos drejtpeshimin e duhur midis të drejtave dhe interesave të ndryshme që rrezikohen. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses miraton kërkesën e palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave për zbatimin e redaktimit të kërkuar në rreshtin 6 të faqes 1272 të transkriptit të seancës gjyqësore të 3 majit 2023. Sa i përket redaktimit të kërkuar në faqen 1263 të të njëjtit transkript, Trupi Gjykses vë në dukje se i gjithë rreshti 22 është redaktuar tashmë në versionin e redaktuar publik të transkriptit dhe, rrjedhimisht, nuk është e nevojshme të ndërmerret asnjë veprim i mëtejshëm.

17. Përveç parashtimeve që përmban Propozimi i Përbashkët, Trupi Gjykses konstaton se në transkriptin e seancës gjyqësore të 3 majit 2023 nevojiten redaktime shtesë, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së dëshmitarëve, viktimave dhe informacioneve konfidenciale.

18. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses: (i) autorizon zbatimin e redaktimeve të reja në përputhje me shtojcën e këtij vendimi; dhe (ii) udhëzon Zyrën Administrative t'i zbatojë redaktimet e reja në versionin e redaktuar publik të transkriptit në përputhje me udhëzimet që përmban shtojca e këtij vendimi. Redaktimet e autorizuar duhet të zbatohen njësoj për transkriptet në gjuhët shqipe dhe serbishte.

19. Në zbatimin e këtij vendimi, Njësia për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ) duhet t'i dorëzojë Kryegjykatëses së këtij Trupi Gjykses një urdhër të vetëm me të gjitha redaktimet e zbatueshme pas seancës për t'u miratuar dhe nënshkruar prej saj. Gjithashtu, NJAGJ-ja udhëzohet që të kontaktojë Trupin Gjykses në rast se del ndonjë problem në zbatimin e këtij vendimi.

B. TRANSKRIPTET E SEANCAVE GJYQËSORE TË MBAJTURA NË SEANCË PRIVATE

20. Trupi Gjykues vë në dukje se palët dhe Mbrojtësi i Viktimave pajtohen se një pjesë e konsiderueshme e transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura në seancë private midis 1 dhe 3 majit 2023 mund të bëhen publike në varësi të zbatimit të redaktimeve.¹¹ Palët dhe Mbrojtësi i Viktimave janë të interesuar kryesisht për redaktimin e: (i) të dhënave personale të dëshmitarëve; (ii) pjesëve të dëshmive të dëshmitarëve që mund të çojnë më tej në identifikimin e tyre; dhe/ose (iii) identitetit të një dëshmitari tjetër të mbrojtur ose të ndonjë personi që ka lidhje familjare ose të tjera me të.

21. Po ashtu, ZMMD-ja është e interesuar për redaktimin e identiteteve të dëshmitarëve të mbrojtur dhe individëve që kanë lidhje familjare ose të tjera me ta, në transkriptet e seancave gjyqësore të 2 dhe 3 majit 2023.

22. Në mënyrë të ngjashme me atë që ka konstatuar në lidhje me transkriptet e seancave të hapura, Trupi Gjykues konstaton se propozimet e palëve, Mbrojtësit të Viktimave dhe ZMMD-së sa u përket transkripteve të seancave private, vendosin drejtpeshimin e duhur midis të drejtave dhe interesave të ndryshme që rrezikohen. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues miraton kërkesat e palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave për riklasifikimin si publike të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura midis 1 dhe 3 Majit 2023, në varësi të zbatimit të redaktimeve të kërkuara dhe udhëzimeve të Trupit Gjykues, siç përcaktohet në shtojcën e këtij vendimi. Po kështu, Trupi Gjykues miraton kërkesën e ZMMD-së për zbatimin e redaktimeve të kërkuara në transkriptet e seancave gjyqësore të 2 dhe 3 majit 2023.

23. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues autorizon riklasifikimin si publike të pjesëve të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura në seancë private dhe zbatimin më pas në to të redaktimeve në përputhje me shtojcën e këtij vendimi.

¹¹ Shtojca 1 e Propozimit të Përbashkët, f. 2-9.

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses udhëzon Zyrën Administrative të riklasifikojë si publike pjesë të transkripteve të seancave private në përputhje me udhëzimet që përmban shtojca e këtij vendimi dhe në varësi të zbatimit të redaktimeve në to. Riklasifikimi i lartpërmendur i transkripteve dhe zbatimi i redaktimeve duhet të zbatohen njësoj për transkriptet në gjuhët shqipe dhe serbishte.

C. MATERIALET AUDIO-VIDEO

24. Trupi Gjykses rikujton se seancat gjyqësore transmetohen në tri gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara të Kosovës, d.m.th. në anglishte, shqipe dhe serbishte, që kërkon ofrim të përkthimit simultan nga Njësia e Përkthimit. Megjithatë, Trupi Gjykses mban parasysh se, edhe pse përkthimi bëhet në mënyrë të njëkohshme, në praktikë ka një vonesë të vogël që përkon me kohën që u nevojitet përkthyesve për ta përpunuar dhe riformuluar informacionin nga një gjuhë zyrtare në një prej dy gjuhëve të tjera zyrtare. Gjithashtu, Trupi Gjykses mban parasysh se, për arsye teknike, redaktimet e materialeve audio-video nuk mund të pasqyrojnë me të njëjtin nivel saktësie redaktimet e autorizuara dhe të përdorura në transkripte.

25. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses autorizon Zyrën Administrative të zbatojë redaktimet gjegjëse në materialet audio-video të transkripteve të seancave gjyqësore përkatëse sipas mundësisë teknike, duke u siguruar që informacioni i redaktuar në transkripte të redaktohet edhe në materialet audio-video.

V. VENDIM**26. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:**

- a) **AUTORIZON** heqjen e redaktimeve ekzistuese në versionet e redaktuara publike të transkripteve në përputhje me paragrafin 14 të këtij vendimi;
- b) **AUTORIZON** zbatimin e redaktimeve të reja në versionet e redaktuara publike të transkripteve në përputhje me paragrafin 18 të këtij vendimi;
- c) **AUTORIZON** riklasifikimin si publike të pjesëve të transkripteve të seancave gjyqësore të mbajtura në seancë private dhe zbatimin më pas në to të redaktimeve në përputhje me paragrafin 23 të këtij vendimi;
- d) **UDHËZON** Administratoren të zbatojë redaktimet në transkriptet e seancave gjyqësore përkatëse, në të gjitha gjuhët, siç përcaktohet në shtojcën e këtij vendimi;
- e) **UDHËZON** Administratoren të riklasifikojë si publike pjesë të transkripteve të seancave gjyqësore, në të gjitha gjuhët, në varësi të redaktimeve të autorizuara, siç përcaktohet në shtojcën e këtij vendimi;
- f) **UDHËZON** Administratoren të zbatojë redaktimet në materialet gjegjëse audio-video të transkripteve të seancave gjyqësore përkatëse në të gjitha gjuhët, sipas mundësisë teknike; dhe
- g) **UDHËZON NJAGJ-në** që të kontaktojë Trupin Gjykues nëse del ndonjë problem në zbatimin e këtij vendimi.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E martë, 11 korrik 2023

Në Hagë, Holandë.